

## Asociacioni në këmbim të integritit të veriut: pazar i drejtë?

Sipas një analisti serb, serbët e Kosovës kanë marrë Asociacionin/Komunitetin, kurse Prishtina ka fituar integritimin e veriut, dhe sipas tij, ky është një pazar i mirë. Shumë serbë të Kosovës dhe parti politike të koalicionit qeverisës në Kosovës pajtohen se ky ka qenë një pazar i drejtë, por partitë politike opozitare dhe një numër i serbëve mbeten skeptik. Të parët thonë se Asociacioni/Komuniteti është një mjet përmes të cilit Beogradi kundërshton shtetin e Kosovës, kurse të dytët thonë se Asociacioni/Komuniteti i intgeron ata “për së tepërmi” brenda Kosovës. Edhe tri vite pas nënshkrimit të marrëveshjes, Asociacioni/Komuniteti ende nuk është krijuar, kurse parimet e tij ende vazhdojnë të rinegociohen.

Pak njerëz kanë pritur që Asociacioni/Komuniteti do të jetë kaq çështje e komplikuar. Ai ka krijuar implikime të paparashikuara ligjore e politike në Kosovë. Legalisht, Gjykata Kushtetuese e ka dobësuar në mënyrë thelbësore marrëveshjen origjinale. Politikisht, partitë opozitare të Kosovës kanë paraqitur një rezistencë të paprecedent e cila faktikisht ka bllokuar plotësisht çfarëdo përpjekje të qeverisë.

Me qëllim të ripërtrirjes së përpjekjeve dhe ndërtimit të momentumit për gjetjen e zgjidhjes rreth Asociacionit/Komunitetit, gjatë muajit prill 2016, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar tri aktivitete: një punëtori me analistë serbë të Kosovës, një takim me zyrtarët e partive politike të shqiptarëve të Kosovës, dhe një tryezë të rumbullakët me serbët dhe partitë politike shqiptare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Folësit serbë kanë argumentuar se Asociacioni/Komuniteti është “çmim i drejtë” të cilin Kosova duhet ta paguajë për integritimin e veriut. Ata kanë kontestuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, duke e konsideruar atë në kundërshtim me frymën e procesit të Brukselit. Një folës ka thënë se “nëse Prishtina dhe Beogradi fillojnë t’i dërgojnë marrëveshjet tek gjykatat e tyre kushtetuese, të gjitha do të konsideroheshin të pavlefshme”. Sipas këtyre folësve, ideja e Brukselit ka qenë që, deri një një masë të pranueshme, të anashkalohen sistemet ligjore ekzistuese të dy vendeve.

Folësit shqiptarë nuk janë po aq të bashkuar kur bëhet fjalë për Asociacionin/Komunitetin. Anëtarët e partive qeverisëse, si dhe disa parti opozitare përkrahin Asociacionin/Komunitetin sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Përfaqësuesit e partisë më të madhe opozitare, Levizjes Vetëvendosje, kundërshtojnë çfarëdo lloji të Asociacionit/Komunitetit, duke thënë se ai është një mekanizëm i cili do t’i shërbejë Beogradit, e jo serbëve të Kosovës.

Aktivitetet e prillit të CIG kanë qenë pjesë e një projekti më të gjërë mbi Kosovën dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës. Projekti financohet dhe implementohet në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

Ky raport paraqet një numër sfidash dhe hapash që kanë të bëjnë me krijimin e Asociacionit/Komunitetit, e të cilat janë shtjelluar gjatë diskutimeve. Përfundimet nuk janë bazuar në konsensus, por reflektojnë pikëpamjet e pjesëmarrësve të ndryshëm. Në jemi munduar të jemi sa më të saktë dhe të balancuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe së këndejmi kërkojmë mirëkuptimin e pjesëmarrësve idetë ose intervenimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë në tërësi në këtë raport të shkurtër, për përmbajtjen e të cilit CIG mban përgjegjësinë e plotë. Diskutimet janë zhvilluar nën rregullat e Chatham House.

## **Sfidat rreth krijimit të Asociacionit/Komunitetit**

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese dobëson në mënyrë thelbësore kompetencat e Asociacionit/Komunitetit të parapara në Marrëveshjen mbi Parimet të vitit 2015. Edhe pse Beogradi ishte pajtuar që marrëveshja të dërgohet tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ai nuk pajtohet me vendimin e gjykatës. Pjesëmarrësit serbë kanë thënë se do të jetë e vështirë për Beogradin dhe serbët e Kosovës që të pranojnë çkado që është më pak se sa marrëveshja e arritur në Bruksel. Ata thonë se Asociacioni/Komuniteti pa kompetenca ekzekutive nuk u shërben mjaftueshëm interesave të serbëve të Kosovës. Në anën tjetër, zyrtarët e Kosovës thonë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese është “sipas definicionit i panegociueshëm”. Por, vendimi i Gjykatës nuk është mjaft i qartë. Siç ka thënë njëri nga pjesëmarrësit, vendimi shpjegon se çfarë Asociacioni/Komuniteti nuk mund të ketë, por jo se çfarë ai do të duhej të kishte.
2. Kushtëzimi i krijimit të Asociacionit/Komunitetit me shpërbërjen e institucioneve paralele të mbetura të Serbisë në Kosovë nga ana e Prishtinës do të mund ta vononte edhe më shumë këtë proces. Një kushtëzim i tillë nuk ka qenë i përfshirë në marrëveshjen e Brukselit, por Prishtina thotë se ka pasur një mirëkuptim nga të dyja palët se shpërbërja e institucioneve paralele do të duhej bërë para krijimit të Asociacionit/Komunitetit. Por Beogradi nuk ka të njejtin mendim rreth kësaj çështje. Serbët e Kosovës besojnë se institucionet paralele ende mbesin një instrument i nevojshëm për serbët. Njëri nga opcionet është që shpërbërja e institucioneve paralele dhe krijimi i Asociacionit/Komunitetit të krijohen në të njejtën kohë me njëra-tjetrën. Një marrëveshje e qartë se si të bëhet një gjë e tillë duhet të arrihet mes Prishtinës e Beogradit. Serbia thotë se rreth 5,500 njerëz janë të punësuar në këto institucione në gjithë Kosovën. Gjetja e një vendi të punës për ta mbetet një sfidë tjetër serioze.
3. Qeveria e Kosovës është duke u ballafaquar me një kundërshtim të fuqishëm nga ana e partive opozitare dhe publiku i gjërë në lidhje me Asociacionin/Komunitetin. Për më shumë, një numër i anëtarëve të koalicionit qeverisës janë poashtu skeptik në lidhje me nevojën për krijimin e Asociacionit/Komunitetit. Përfaqësuesit serbë shpjegojnë se Asociacioni/Komuniteti nuk paraqet kërcënim për Kosovën. Ata thonë se krijimi i Asociacionit/Komunitetit mundëson integrimin e veriut dhe financimin transparent nga ana e Beogradit.

4. Niveli i përgjegjësive të Asociacionit në katër fusha, posaçërisht në arsim dhe shëndetësi, mbetet ende i paqartë. Prishtina insiston që komunat t'i menaxhojnë këto fusha. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese poashtu ka konfirmuar se kompetencat komunale nuk mund të transferohen tek një institucion tjetër. Serbët e Kosovës dhe Beogradi thonë arsimi dhe shëndetësia do të duhej të menaxhoheshin nga Asociacioni/Komuniteti. Për momentin, ministritë përkatëse të Serbisë e menaxhojnë arsimin dhe shëndetësinë për serbët në Kosovë. Nëse arrihet një marrëveshje, atëherë Ministria e Arsimit dhe Shëndetësisë e Serbisë do të duhej t'i transferonte kompetencat e saj tek Asociacioni. Përveç implikimeve politike, një proces i tillë do të ishte poashtu teknikisht i komplikuar.

## **Hapat për të filuar implementimin**

1. Prishtina dhe Beogradi duhet të fillojnë punën në krijimin e Asociacionit/Komunitetit pa kushte. Prishtina insiston që së pari të shpërbëhen institucionet paralele, por një gjë e tillë nuk ka qenë pjesë e marrëveshjes. Si kompromis, Prishtina do të mund të kërkonte një shpërbërje graduale e cila do të përfundonte në kohën kur do të krijohet Asociacioni/Komuniteti. Shumë nga serbët thonë se për momentin, disa nga institucionet paralele janë të domosdoshme në mënyrë që popullatës serbe t'u ofrohen një numër i caktuar shërbimesh. Institucionet kryesore paralele—policia, mbrojtja civile dhe gjykatat—tashmë ose janë integruar, ose marrëveshjet për integrimin e tyre veçse janë arritur. Megjithatë, partitë opozitare të Kosovës thonë se ky integrim është sipërfaqësor, apo “integrim i uniformave”.
2. Ekipi ekzistues i përbërë nga katër përfaqësues të serbëve të Kosovës të mandatar për ta draftuar statutin nuk ka prodhuar asnjë draft preliminar. Një ekip i ri për këtë qëllim duhet të krijohet dhe do të duhej të përfshinte përfaqësues nga qeveria e Kosovës (përfshirë serbët e Kosovës), qeveria e Serbisë, si dhe komuniteti ndërkombëtar. Edhe pse disa nga përfaqësuesit e Kosovës kundërshtojnë pjesëmarrësit nga Beogradi, përfaqësimi i tyre do t'a obligonte Beogradin që ta implementojë marrëveshjen.
3. Ekipi do të duhej që fillimisht t'i definojë aspektet e katër fushave - arsimit, shëndetësia, planifikimi urban, dhe zhvillimi ekonomik—të cilat Asociacioni/Komuniteti do të duhej t'i “mbikqyrte” në bazë të marrëveshjes. Ekspertët dhe anëtarët e shoqërisë civile poashtu do të duhej të ofronin ekspertizën e tyre në këtë drejtim.
4. Partitë opozitare të Kosovës do të duhej që së paku në mënyrë të heshtur ta përkrahin krijimin e Asociacionit/Komunitetit në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Edhe pse nuk pritet që ata të jenë pjesë e ekipit për draftimin e statutit, megjithatë ata do të duhej të jenë të angazhuar përmes dhënies së rekomandimeve dhe propozimeve, apo edhe kundërshtimeve konkrete.
5. Serbët e Kosovës duhet të jenë më të angazhuar dhe të luajnë një rol më të madh në formësimin e substancës së Asociacionit/Komunitetit. Ata duhet t'i artikulojnë në terma më konkret përgjegjësitë e Asociacionit/Komunitetit dhe mënyrën se si Asociacioni/Komuniteti do të mund të shërbente si mekanizëm për mbrojtjen e interesave të tyre. Angazhimi i tyre publik do të ndihmonte shumë në adresimin e frikës tek shqiptarët, të cilët kosniderojnë se

Asociacioni/Komunitetit po krijohet për të mbrojtut interesat e Beogradit, e jo të serbëve të Kosovës. Përfaqësuesit shqiptarë preferojnë një komunitet serb më të pavarur, i cili mbështetet më pak tek Beogradi dhe i cili bashkëpunon më ngushtë me Prishtinën. Ata thonë se Beogradi është duke e keqpërdorur komunitetin serb me qëllim të avancimit të interesave të Serbisë, e jo të serbëve të Kosovës. Disa kanë pyetur se çfarë marrëdhënie ekziston mes serbëve të Kosovës dhe Beogradit: marrëdhënie e ndërvarësisë, nënshtrimit apo varësisë? Kush përfiton më shumë nga kush? A do t'u ofronte më shumë benefite serbëve të Kosovës një bashkëpunim më i ngushtë me Prishtinën? Një folës ka thënë se votat mund të jenë manipuluar në veri, porse Lista Serbe ka fituar edhe në pjesë tjera të Kosovës. Ky folës ka shtuar se njerëzit kanë votuar për të, me qëllim të marrjes së më shumë benefiteve nga një marrëdhënie edhe më e fuqishme me Beogradin.

6. Nje “proces i të menduarit të thellë” mes serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve duhet të inicohet. Një proces i tillë nuk do të ishte thjesht një dialog, por një diskutim thelbësor i problemeve, përfshirë edhe Asociacionin/Komunitetin. Disa nga folësit kanë propozuar që ky dialog të fokusohet në zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik mes komuniteteve në Kosovë. Ky proces poashtu do të duhej të përfshinte grupe të aktivistëve lokal të fushës së kulturës, sportit dhe rinisë. Marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, përkrahja e publikut të gjërë për dialogun e Brukselit, si dhe implementimi i marrëveshjes nuk do të përmirësohen përderisa të mos ketë përmirësim të mëtejshëm të marrëdhënieve mes Beogradit e Prishtinës. Por një gjë e tillë poashtu nuk do të ndodhë nëse nuk ka një dialog të brendshëm në Kosovë. Një vullnet më i madh politik është i nevojshëm në mënyrë që një dialog i tillë të fillojë, si dhe institucione më të fuqishme në mënyrë që rezultatet e dialogu të implementohen.
7. Të forcohet mirëbesimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Një besim i tillë i ndërsjellë është kyç në procesin e krijimit të Asociacionit/Komunitetit dhe në integrimin e përgjithshëm të komunitetit serb. Një besim i tillë fitohet përmes komunikimit të shtuar, projekteve të përbashkëta dhe përkushtimit më të madh në zgjidhjen e problemeve sociale e ekonomike. Këto çështje përfshijnë respektimin e kuotave të punësimit dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me pronat private.

Kompromiset janë të nevojshme për krijimin e Asociacionit, integrimin e veriut, dhe për vazhdimin e dialogut të Brukselit. Palët duhet të gjejnë mënyra se si t'i shmangen pengesave politike e ligjore. Për shembull, Prishtina e ka konsideruar marrëveshjen e vitit 2013 si marrëveshje ndërkombëtare, duke e evituar kështu rishikimin e saj nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Beogradi nuk i konsideron këto marrëveshje si marrëveshje ndërkombëtare, por megjithatë nuk i dërgon ato në Gjykatën Kushtetuese.

## **Pjesëmarrësit**

### **Punëtorja me serbët e Kosovës**

**Ljubisa Mijacic**, Analist, Zubin Potok

**Petar Miletic**, Ish-nënkryetar i Parlamentit të Kosovës

**Miodrag Milicevic**, Drejtor ekzekutiv, OJQ Aktiv

**Dusan Radakovic**, Drejtor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike

**Nenad Radosavljevic**, Drejtor, RTV Mir, Leposaviq

**Igor Simic**, Anëtar i Kuvendit Komunal, Mitrovicë Veri

**Nenad Rasic**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lista Serbe

### **Tryeza e rrumbullakët me përfaqësuesit shqiptarë**

**Valdete Bajrami**, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Iniciativa për Kosovën Nisma

**Ilir Deda**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Ardian Gjini**, Nënkryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

**Enver Hoti**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Iniciativa për Kosovën Nisma

**Blerim Kuci**, Anëtar i Kryesisë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

**Naim Rashiti**, Drejtor ekzekutiv, Grupi i Ballkanit për Hulimtim të Politikave

**Armend Zemaj**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

### **Tryeza e rrumbullakët me përfaqësuesit serbë dhe shqiptarë**

**Ilir Deda**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Aida Derguti**, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Sadri Ferati**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

**Bajram Gecaj**, Zëvendësminister, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Ardian Gjini**, Nënkryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

**Dukagjin Gorani**, Kryetar, Common Voice

**Enver Hoti**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Iniciativa për Kosovën Nisma

**Adriatik Kelmendi**, Kryeredaktor, TV Kohavision

**Glauk Konjufca**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje

**Ljubisa Mijacic**, Analist, Zubin Potok

**Petar Miletic**, Ish-nënkryetar i Parlamentit të Kosovës

**Miodrag Milicevic**, Drejtor ekzekutiv, OJQ Aktiv

**Zenun Pajaziti**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës

**Dusan Radakovic**, Drejtor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike

**Nenad Radosavljevic**, Drejtor, RTV Mir, Leposaviq

**Naim Rashiti**, Drejtor ekzekutiv, Grupi i Ballkanit për Hulimtim të Politikave

**Besa Shahini**, Analiste e pavarur

**Armend Zemaj**, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës

**Samuel Zbogar**, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë

### **Përfaqësuesit e CIG dhe FDFA në të trija takimet**

**Shpetim Gashi**, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Arber Kuci**, Bashkëpunëtor në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Krystyna Marty Lang**, Ambasadore e Zvicrës në Kosovës  
**Saskia Salzmann**, Këshilltare Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i  
Punëve të Jashtme i Zvicrës  
**Talia Wohl**, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës